



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 21.0.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (Udhëheqës Ekipi) Refiqe Morina dhe Hysen Restelica (Anëtarë), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Arvita Zyferi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1. Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2. Qeverisja.....	9
3. Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	17
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	18
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	21
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	22

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore i Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRK) për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 21/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i KRK-së.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

### Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



### Përgjigja e menaxhmentit të KRR-së - auditimi 2016

Menaxhmenti i KRR-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

# 1. Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Sekretari i Përgjithshëm i KRK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KRK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013 për shpenzimin i parave publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raportet tremujore, përfshirë pasqyrat financiare nëntëmujore;
- Raportet për obligimet e papaguara;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



## 2. Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KRK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KRK-ja gjatë vitit 2016 ka shënuar progres të theksuar në aranzhimet e qeverisjes së mirë krahasuar me vitin paraprak. Kjo për faktin që KRK-ja ka vendosur procedura të duhura për menaxhimin e rrezikut që përfshinë identifikimin, vlerësimin dhe analizën e rreziqeve të cilat janë të rëndësishme për arritjen e objektivave dhe përcaktimin e përgjigjeve të përshtatshme ndaj këtyre rreziqeve. Më tutje, pyetësi i vet-vlerësimit ishte plotësuar në përputhje me kërkesat e MFK-së, ku përgjigjet e dhëna korrespondojnë me gjendjen faktike dhe dokumentet mbështetëse konfirmojnë saktësinë e tyre. Po ashtu zbatimi i rekomandimeve si mjet kyç i qeverisjes së mirë ishte marrë parasysh nga menaxhmenti i KRK-së dhe ishin ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre në nivel të kënaqshëm.

---

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar me katër (4) rekomandime. KRK-ja kishte përgatitur një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka monitoruar zbatimin e atij plani.

Përveç rekomandimit lidhur me regjistrimin e plotë të pasurisë jo kapitale në sistemin e-pasuria i cili ishte në proces të zbatimit, rekomandimet tjera ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih shtojcën III.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të KRK-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi. Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij, dhe kemi vërejtur se KRK:

- ka hartuar planin vjetor dhe strategjik të saj si dhe ka përcaktuar strategji të përgjithshme të objektivave, si dhe janë qartësuar përgjegjësitë për koordinim dhe zhvillim të planit strategjik; dhe
- ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, duke e hartuar planin detaj për trajtimin e rreziqeve të organizatës.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KRK-ja operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Proceset e Menaxhimit të rrezikut

Menaxhimi i rrezikut si proces i përgjithshëm i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të rreziqeve, si dhe zbatimit të kontrolleve të nevojshme për të mbajtur ekspozimin ndaj rrezikut në nivel të pranueshëm është integruar si pjesë e procesit të përgjithshëm të menaxhimit.

Sipas udhëzimeve të përcaktuara me procedurat e MFK-së dhe rregullës 01/2010, të gjitha organizatat buxhetore duhet të hartojnë një regjistër të menaxhimit të rreziqeve i cili duhet t'i paraprijë procesit të identifikimit të rreziqeve dhe vlerësimit të tyre me qëllim zvogëlimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm për të mbështetur një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik.

KRK-ja gjatë vitit 2016 kishte arritur të hartojë regjistrin e rreziqeve në të cilin kishte bërë identifikimin e rreziqeve, mënyrën e menaxhimit dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Për të siguruar funksionimin e sistemit financiar dhe kontrollit duhet të zbatohen një sërë kontrollesh të brendshme. Është e rëndësishme që ato kontrolle të përfshijnë një strukturë efikase organizative, delegimin e duhur të përgjegjësisë dhe raportimin e rregullt tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj sfidave dhe problemeve operative të identifikuar.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. KRK-ja ka vendosur një sistem funksional të kontrollit të brendshëm që përfshinë raportimin e rregullt tek menaxhmenti, për të mundësuar një informim me kohë dhe mundësi për përgjigje ndaj sfidave dhe problemeve të raportuara në drejtim të arritjes së objektivave.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një (1) auditor i cili është drejtor i njësisë. NjAB në përputhje me planin strategjik kishte përgatitur planin vjetor për vitin 2016, ku kishte planifikuar kryerjen e katër (4) auditimeve të rregullta dhe një (1) për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të NjAB-së për vitet paraprake. Auditimet ishin realizuar në përputhje me planin. Përmes raporteve të auditimit, menaxhmentit i janë ofruar informata në lidhje me funksionimin e sistemit financiar dhe vlerësime për funksionimin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme.

Po ashtu edhe Komiteti i Auditimit ishte efektiv duke mbajtur takime të rregullta gjatë vitit 2016. Në ato takime ishin vlerësuar dhe trajtuar çështjet e paraqitura në raportin e auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015 si dhe çështjet e ngritura nga auditimi i brendshëm.

### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3. Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Megjithatë, kontrollet në fushën e subvencioneve dhe menaxhimit të pasurisë jokapitale mbeten çështje të cilat ende kanë nevojë për përmirësime.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Këto janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>9,174,515</b>	<b>8,607,527</b>	<b>8,517,980</b>	<b>7,951,987</b>	<b>6,470,018</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,174,515	8,607,527	8,517,980	7,951,987	6,470,018

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6.18% apo 566,988€. Ndryshimi i buxhetit ishte bërë me rishikim të buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

KRK-ja ka përdorur 99% të buxhet final, duke shënuar një ngritje prej 4% në krahasim me vitin paraprak (95%). Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>9,174,515</b>	<b>8,607,527</b>	<b>8,517,980</b>	<b>7,951,987</b>	<b>6,470,018</b>
Pagat dhe Mëditjet	6,288,756	6,003,756	5,920,870	6,060,091	4,932,396
Mallrat dhe Shërbimet	1,688,759	1,618,036	1,612,982	1,124,772	966,860
Shërbimet komunale	241,000	176,436	176,436	180,280	143,626
Subvencionet dhe Transferet	60,000	117,162	117,162	120,000	6,800
Investime Kapitale	896,000	692,137	690,530	466,844	420,336

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 285,000€. Fillimisht, buxheti fillestar ishte rritur për 10,000€ me rishikim buxhetor, pastaj buxheti është zvogëluar për 295,000€ sipas vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi ishte afro 99% të buxhetit final;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 70,723€ si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit ishte afro 100% të buxhetit final;
- Buxheti final për Shërbime Komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 64,564€. Fillimisht, me vendim të Qeverisë 42,000€ janë transferuar nga kjo kategori në kategorinë subvencione dhe transfere, pastaj sipas vendimit të Qeverisë për kursime buxhetore buxheti është zvogëluar për 22,564€. Realizimi ishte në masën 100% e buxhetit final;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 57,162€, si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë. Realizimi ishte në masën 100% të buxhetit final; dhe
- Buxheti final për Investime Kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 203,863€. Fillimisht, buxheti fillestar ishte rritur për 200,000€ me vendim të Qeverisë për projektin e blerjes së skanerëve, pastaj ishte shkurtuar me rishikim buxhetor dhe vendimin e Qeverisë për kursime buxhetore për 403,863. Realizimi ishte afro 99% e buxhetit final.

### 3.1.1 Pagat dhe mëditjet

KRK-ja gjatë vitit 2016 për paga dhe mëditje kishte shpenzuar 5,920,870€, apo 99% të buxhetit final. Përveç pagës, punonjësit e administratës së Kuvendit dhe stafi mbështetës politik përfitojnë edhe kompensime shtesë të aprovuara me akte të veçanta dhe vendime të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pagesa e pagave dhe mëditjeve bëhet përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). KRK-ja ka vendosur kontrolle funksionale në këtë fushë.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë Komunalitë) në vitin 2016 ishte 1,794,472€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,789,418€, apo 100% e buxhetit final. KRK-ja ka vendosur kontrolle funksionale në menaxhimin e buxhetit për këtë kategori.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 117,162€. Gjatë vitit 2016 buxheti final në këtë kategori ishte shpenzuar në tërësi. Kontrollat në fushën e subvencioneve dhe transfereve ishin të mira, megjithatë nevojiten veprime shtesë për eliminimin e mangësive në planifikimin e buxhetit për subvencioneve.

## Çështja 1 - Mangësi në planifikimin e buxhetit për subvencione - Prioritet i mesëm

<b>E gjetura</b>	Bazuar në LMFPP, ndarja buxhetore duhet të bëhet në përputhje me qëllimin e specifikuar në kërkesat buxhetore. Shpenzimet për subvencione në vlerë prej 60,000€ për KRK-në ishin përfshirë në ligjin e buxhetit për vitin 2016, pa u specifikuar qëllimi i ndarjes së subvencioneve. Ky qëllim nuk ishte specifikuar as me kërkesën për ndarjen shtesë në bazë të rishikimit të buxhetit për vitin 2016.
<b>Rreziku</b>	Mos specifikimi i qëllimit të dhënies së subvencioneve me rastin e ndarjes buxhetore rrit rrezikun që mjetet buxhetore të shfrytëzohen për qëllime tjera të pa planifikuara.
<b>Rekomandimi 1</b>	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e kërkesave buxhetore janë specifikuar qëllimet për dhënien e subvencioneve dhe se ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara.

### 3.1.4 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë neto të KRRK-së në fund të vitit 2016 ishin 6,959,774€. Prej tyre 6,561,903€ ishin pasuri kapitale me vlerë mbi 1,000€, 358,731€ ishin pasuritë me vlerë nën 1,000€, ndërsa 39,140€ ishte vlera e stoqeve.

Regjistrat ishin mbajtur në pajtueshmëri me rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Po ashtu në fund të vitit ishte bërë inventarizimi i pasurisë siç kërkohet me këtë rregullore. Kontrollat në këtë fushë janë funksionale dhe nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur me përjashtim të mangësive sa i përket regjistrimit të disa pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria.

#### Çështja 2 - Mos regjistrimi i pasurisë jokapitale në regjistrin e-pasuria - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Sipas rregullore NR.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, pasuritë jokapitale me vlerë nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në regjistrin e-pasuria. Megjithatë, pasuritë jokapitale me vlerë nën 1,000€ të cilat ishin blerë para vitit 2011, ende nuk ishin regjistruar në regjistrin e -pasuria, por në një regjistër të brendshëm në formatin excel, ku janë të evidentuar të gjitha pasuritë.

**Rreziku** Regjistrimi i pasurisë në dy baza të ndryshme vështirëson menaxhimin efektiv të saj. Po ashtu informatat financiare rreth pasurisë mund të mos përmbushin kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit.

**Rekomandimi 2** Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit për menaxhimin e pasurisë e-pasuria.

### 3.2 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 133,467€. Faturat për obligimet e papaguara kryesisht i takonin muajit dhjetor 2016 të cilat nuk ishin paguar për shkak të mbylljes së sistemit të pagesave.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

### Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Menaxhimi i rrezikut	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë avancimin e mëtutjeshëm të planit për menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë në të edhe masat dhe veprimet që menaxhmenti planifikon të ndër marrë në tejkalimin e sfidave të identifikuar.	Po		
Sistemi i auditimit të brendshëm	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se secila njësi e audituar ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në implementimin e plotë të rekomandimeve të AB-së.	Po		
Prokurimi	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i prokurimit pasqyron qartazi furnizimet dhe shërbimet që pritet të realizohen përmes procedurave të prokurimit. Kjo të mbështetet nga njësit kërkuese nga të cilat pritet të ofrojnë informata më të detajuara të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme, të përcjella me hulumtime dhe analiza rreth çmimeve aktuale të tregut. Po ashtu, AQP të njoftohet me kohë për aktivitetet e pa planifikuara të prokurimit. Te menaxhimi i kontratave, komisionet e pranimit të mallrave të zbatojnë në tërësi kërkesat kontraktuale gjatë pranimit të mallrave, dhe raportet e pranimit të ofrojnë informata të mjaftueshme dhe të konfirmojnë përmbushjen e plotë të kushteve të kontratës.	Po		
Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se pasuritë jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit për menaxhimin e pasurisë e-pasuria		Në proces të zbatimit. Pasuritë jo kapitale të blera para vitit 2011 ende nuk janë regjistruar në regjistrin e-pasuria.	

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupstina - Assembly*

---

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve


Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar Draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ismet Krasniqi,

  
Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Data: 5 qershor 2017